

Gjendja me COVID-19 në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe në botë

Gjendja me COVID-19 në Republikën e Maqedonisë së Veriut 03-09.02.2025

Janë testuar gjithsej 328 materiale në Laboratorët ku bëhen analiza molekulare për vërtetimin e pranisë së virusit SARS-CoV-2. Krahasuar me javën që shkoi (n=325) është shënuar një rritje prej 3 rastesh.

Janë regjistruar 4 raste pozitiv, 2 më pak se javën që shkoi.

Tabela 1. Numri i testimeve dhe rasteve pozitive në periudhën nga 03-09.02.2025

Data	Testime	Pozitive	% e rasteve pozitive
03.2.2025	76	2	2,6%
04.2.2025	53	1	1,9%
05.2.2025	42	0	0,0%
06.2.2025	46	0	0,0%
07.2.2025	63	1	1,6%
08.2.2025	32	0	0,0%
09.2.2025	16	0	0,0%
Gjithsej	328	4	Mesatarisht 0,9%

Personat e sëmurë gjatë javës që shkoi janë nga Shkupi (n=2), Shtipi (n=1) dhe Struga (n=1).

Gjatë javës së kaluar (10-16.02.2025) janë regjistruar si të shëruar 6 persona, ndërkohë që është nuk janë raportuar raste të vdekjes si pasojë e COVID-19.

GJENDJA ME COVID-19 NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT NË VITIN 2025

Gjatë vitit 2025, deri më 09.02.2025, janë regjistruar gjithsej 24 raste me COVID-19. Në muajin janar të vitit 2025 (20) numri i të sëmurëve është për 3,3 herë më i lartë se sa në muajin dhjetor 2024 (n=6).

Gjatë vitit 2025, deri më 09.02.2025, janë testuar gjithsej 1.702 materiale, në laboratorët në të cilët realizohen testime molekulare për prani të SARS-CoV-2 dhe në laboratorët / institucionet shëndetësore në të cilat bëhen testimet e shpejta antigjene.

Vlerësimi i rrezikut

Shkalla e ulët e transmetimit të SARS-CoV-2, rënia e numrit të raportimeve dhe testimeve ndikon në aftësinë për vlerësimin e gjendjes epidemiologjike. Popullata e EU/EEA në përgjithësi ka një nivel të konsiderueshëm të imunitetit hibrid (vaksinim/vaksinim me booster doza), që ofron një mbrojtje nga format e rënda të sëmundjes.

Personat mbi 60 vjet janë më të rrezikuar nga pasqyra e rëndë e sëmundjes.

Hospitalizimi i personave me COVID-19 të konfirmuar, pranimet në kujdesin intensiv dhe vdekjet mbeten në nivel të ulët në vendet e BE-së. Këto të dhëna nuk janë të disponueshme në R. e Maqedonisë së Veriut.

Edhe pse numri i të sëmurëve me COVID-19 në javë po shënon rënie, duke pasur parasysh se fillon periudha e qarkullimit të shtuar të viruseve respiratore në hemisferën veriore, ekziston rreziku që aktiviteti i SARS-CoV-2 të rritet, gjë që e thekson nevojën e vazhdueshme për mbikëqyrje (epidemiologjike dhe virologjike) në nivel kombëtar dhe rajonal.

Masa të rekomanduara për parandalim dhe kontroll

Rekomandohet ndjekja e masave themelore për parandalimin e COVID-19 dhe sëmundjeve të tjera respiratore.

Vaksinimi mbetet si masë specifike që mundëson mbrojtje nga format e rënda të sëmundjes, edhe pse ky efekt mbrojtës me kalimin e kohës dobësohet. Mbetet rekomandimi për vaksinimin e personave me rrezik të lartë nga format e rënda të sëmundjes (siç janë personat më të moshuar).¹

Shkup, 10.02.2025

Departamenti i epidemiologjisë të sëmundjeve ngjitëse

Instituti i Shëndetit Publik

¹ <https://www.ecdc.europa.eu/sites/default/files/documents/2024-WCP-0039%20Final.pdf>